**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

# RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| Eksperti Shqyrtues | Data e pranimit të ekspertit | Date e dorëzimit të raportit | Nr. i lëndës |
|---|---|---|---|
| **Blerina Huruglica** | **26.01.2024** | **05.02.2024** | **2024/0054** |

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 17.01.2024, **OE “" Profitech " SH.P.K.”- Prishtinë,** ka parashtruar ankesë me nr: **2024/0054**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë **OE "Aquatic SH.P.K.”** lidhur me aktivitetin e prokurimit: **“Furnizim me Polielektrolit anjonik”** me nr. të prokurimit: **"70433736-23-13535-1-3-6"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL PRISHTINA SH.A.**

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë kuotim i çmimit, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: **9,900.00 €.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 – Qëllimi

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 38 - Sqarimi i Tenderëve i Rregullores Nr.001_2022

Bazuar në "Njoftimin mbi Vendimin e Autoriteti Kontraktues" të datës: 05.01.2024, vendimi i marr nga Komisioni Vlerësues është i pa bazuar;

Për informatën tuaj më datë: 26.12.2023, na është dërguar përmes platformës e-prokurimi "Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues" në të cilin vendim kompania jonë Profitech sh.p.k. është rekomanduar për kontratë.

Pas këtij vendimi më datë 05.01.2024, na është dërguar përmes platformës e-prokurimit "Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues" ku Autoriteti Kontraktues shpërblen me kontratë një OE tjetër i cili është me çmim më të lartë se çmimi i ofertuar nga ana jonë si dhe na është dërguar "Letra Standarde për Tenderuesin e Eliminuar" ku arsyetimi i eliminimit tonë nga ana e Autoriteti Kontraktuese është bazuar në Kërkesën për Rishqyrtim e cila është bërë nga një Operator Ekonomik tjetër me çmimin më të lartë të ofertës nga të gjithë OE të tjerë pjesëmarrës.

Ne jemi eliminuar nga Autoriteti Kontraktues për arsyetimin si më poshtë: Dokumentacioni i kërkuar nga prodhuesi (Specifikacioni teknik) nuk eshte dorëzuar. Mungon dokumenti per verifikimin e Mesi i pH-se efektiv 3-11 (me efektiv ka mesi alkalin) Bazuar ne Rregulloren Nr.001_2022 për prokurimin publik, Neni 38, Sqarimi i Tenderëve; Autoriteti Kontraktues është dashur që të bënte një "Kërkesë për Sqarimin e Tenderit" e jo automatikisht të procedohet me eliminim.

Sqarim:

Produkti i ofruar nga ana jonë: Superfloc® A-110PWG nga Prodhuesi i njohur botërisht Kemira Oyj, i plotëson të gjitha kriteret dhe rregulloret siç janë në përputhshmëri me standardin CEN 1407:2008 i cili dëshmon se polielektroliti i ofruar përdoret për trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor.

Prodhuesi Kemira Oyj, është themeluar në vitin 1920 me përvojë mbi 100 vite ku është e renditur njëri nga të parët nga Top prodhuesit më të mëdhenj global sa i përket prodhimit të kimikateve për trajtimin e ujërave.

Të njëjtin produkt Superfloc® A-110PWG e kemi liferuar për vite me radhe tek AK KUR Prishtina SH.A. si dhe kemi pranuar referenca për liferimin e produktit në fjalë. Për të dëshmuar se Produkti i ofruar nga ana jonë Superfloc® A-110PWG është në përputhshmëri me kërkesat sipas specifikacionit teknik në dosje të tenderit gjegjësisht Mesin e pH-se efektiv 3-11, të bashkëngjitur mund të gjeni Deklaratën nga Prodhuesi Kemira.

Po ashtu në dokumentacionin e ofruar nga ana jonë: 3. TDS_Superfloc A□110PWG_EN.pdf, në faqe Nr. 1, tek Benefits (Përfitimet) është e cekur: Effective over a wide range of pH; does not alter the system pH. (Është Efektiv në një gamë të gjerë të pH-së: nuk ndryshon pH-në e sistemit) Që do të thotë se produkti i ofruar Superfloc® A-110PWG operon në mënyre efektive në një gamë të gjerë të pH-së pa e ndryshuar pH-në e sistemit.

Vlen të cekët po ashtu se çmimi i ofruar nga ana jonë është për 1,575.00 € rreth (17 %) më i ulët se OE i rekomanduar për kontratë, ku AK në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 sipas Neni 1 Qëllimi, ka për qëllim të siguroj mënyrën

më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera. dhe Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, paragrafi 1, ku: Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Bazuar në ankesën tonë kërkojmë nga ana juaj të merrni këtë vendim:

**VENDIM**

**APROVOHET** si e bazuar Ankesa e OE "Profitech sh.p.k."

**ANULOHET** Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të publikuar më datë: 05.01.2024, lënda të kthehet në rivlerësim dhe më pas të ri-shpallet fitues OE "Profitech sh.p.k."

KRITERET PËR VLERËSIM

**ANEKSI 1.SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

**SPECIFIKIMI TEKNIK**

| Objekti | Specifikacionet funksionale | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| 1 | Polielektrolit anjonik | kg | 1500 |

**Polielektrolit anjonik**
CAS No: 9003-05-8
CEN-1407:2008

| | |
|---|---|
| Tipi | Anjonik Polyacrylamid |
| Dukja | Tejdukshme-pluhurë granulë |
| Dendesia | 0.4-0.8 g/cm3 |
| pH ( 0.5%) tretesire ujore jo destiluar | 7-9 |
| Gjendja agregate ose forma | Pluhur /gjel viskoz |
| Mesi i pH-se efektiv | 3-11 ( me efektiv eshte ka mesi alkalin) |
| Hidroliza | 20 deri 30% |
| Viskozicitetit 25 °C (cP/ mPa sec) | 200-300cps(0.1%) |
| 0.10% | 150cps |
| 0.25% | 350cps |
| 0.5% | 700cps |

## RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSIT SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
RAGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABEVANJE D.D.
PRISHTINA

**NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES**

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

**Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:** Furnizim me Polielektrolit anjonik

**Numri i aktivitetit te prokurimit:** 70433736-23-13535-1-3-6 // KRUP-23-068-136

| Nr. | Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik | Vlera totale e ofertës |
|---|---|---|
| 1. | " Profitech " SH.P.K., 810081646 | 7,860.00 € |
| 2. | AQUATIC SH.P.K., 811937939 | 9,435.00 € |
| 3. | Grup i Operatorëve Ekonomik ASET SH.P.K.; Grami SH.P.K., | 9,720.00 € |

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:
KRU PRISHTINA SH.A. shpërblen me kontratë kompanine si ne vijim: **AQUATIC SH.P.K.,**
"ne vlere prej **9,435.00 €**

## INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

NA

## VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

## VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

## ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

## PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **" Profitech " SH.P.K.**

Aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me Polielektrolit anjonik"** me nr. të prokurimit: **"70433736-23-13535-1-3-6"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL PRISHTINA SH.A, ka filluar me njoftimin për kontratë me datë 05.12.2023, hapja e ofertave është bere me date 12.12.2023, njoftimi B58 publikohet me date 26.12.2023, ku rekomandohet për kontratë OE ankuesi Profitech SHPK, gjerësa pas kërkesës për rishqyrtim nga OE, si rezultat i aprovimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK, aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim, ku me datë 05.01.2024 AK publikon vendimin B58- rekomandon OE Aquatic SHPK.**

**OE ankuesi eliminohet me arsyetimin:**

**Dokumentacioni i kërkuar nga prodhuesi (specifikacioni teknik) nuk është dorëzuar, Mungon dokumenti për verifikimin e Mesi i pH-së efektive 3-11 (me efektiv është ka mesi alkalin).**

Tutje, i njëjti i pa kënaqur me vlerësimin e AK-së, pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, me datë 19.01.2024 parashtron ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK ka eliminuar pa drejtësisht dhe se gjatë vlerësimit të ofertave ka shkelë LPP-në përkatësisht nenet: 1,6,7,59, dhe nenin 38 të rregullores nr 001/2022.

**Pretendimi i OE ankues kundër arsyes së eliminimit:**

*Sqarim:*

*Produkti i ofruar nga ana jonë: Superfloc® A-110PWG nga Prodhuesi i njohur botërisht Kemira Oyj, i plotëson të gjitha kriteret dhe rregulloret siç janë në përputhshmëri me standardin CEN 1407:2008 i cili dëshmon se polielektroliti i ofruar përdoret për trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor.*

*Prodhuesi Kemira Oyj, është themeluar në vitin 1920 me përvojë mbi 100 vite ku është e renditur njëri nga të parët nga Top prodhuesit më të mëdhenj global sa i përket prodhimit të kimikateve për trajtimin e ujërave.*

*Të njëjtin produkt Superfloc® A-110PWG e kemi liferuar për vite me radhe tek AK KUR Prishtina SH.A.*

*si dhe kemi pranuar referenca për liferimin e produktit në fjalë. Për të dëshmuar se Produkti i ofruar nga ana jonë Superfloc® A-110PWG është në përputhshmëri me kërkesat sipas specifikacionit teknik në dosje të tenderit gjegjësisht Mesin e pH-se efektiv 3-11, të bashkëngjitur mund të gjeni Deklaratën nga Prodhuesi Kemira.*

*Po ashtu në dokumentacionin e ofruar nga ana jonë: 3. TDS_Superfloc A110PWG_EN.pdf, në faqe Nr. 1, tek Benefits (Përfitimet) është e cekur: Effective over a wide range of pH; does not alter the system pH. (Është Efektiv në një gamë të gjerë të pH-së: nuk ndryshon pH-në e sistemit) Që do të thotë se produkti i ofruar Superfloc® A-110PWG operon në mënyre efektive në një gamë të gjerë të pH-së pa e ndryshuar pH-në e sistemit.*

**Ekspertja Shqyrtuese** pas analizimit, shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, AK në DT përkatësisht në Ankes 1 tek specifikat tenike të detyrueshme ka kërkuar:

**ANEKSI 1.SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME**

**SPECIFIKIMI TEKNIK**

| Objekti | Specifikacionet funksionale | Njësia | Sasia |
|---|---|---|---|
| 1 | Polielektrolit anjonik | kg | 1500 |

**Polielektrolit anjonik**
CAS No: 9003-05-8
CEN-1407:2008

| | |
|---|---|
| Tipi | Anjonik Polyacrylamid |
| Dukja | Tejdukshme-pluhurë granulë |
| Dendesia | 0.4-0.8 g/cm3 |
| pH ( 0.5%) tretesire ujore jo destiluar | 7-9 |
| Gjendja agregate ose forma | Pluhur /gjel viskoz |
| Mesi i pH-se efektiv | 3-11 ( me efektiv eshte ka mesi alkalin) |
| Hidroliza | 20 deri 30% |
| Viskozicitetit 25 °C (cP/ mPa sec) | 200-300cps(0.1%) |
| 0.10% | 150cps |
| 0.25% | 350cps |
| 0.5% | 700cps |

Kurse specifikat e ofruara nga OE janë si mëposhtë, në të cilën vërehet se nuk janë konform kërkesës, pra mesi i PH-se efektive 3-11 mungon, si e tillë **pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar.**

kemira

Where water meets chemistry ™

**Technical Data Sheet** 2 (2)

June 18

**Typical Product Properties**

| | A-110 PWG |
|---|---|
| Chemical Type | Anionic Polyacrylamide |
| Appearance | Off-white, Granular Powder |
| Relative Charge | Low |
| Molecular Weight | High |
| Bulk Density (kg/litre) | 0.80 |
| pH of 0.5% solution (25°C) | 7-9 |
| Viscosity @ 25°C (cP / mPa sec) | |
| 0.10% | 150 |
| 0.25% | 350 |
| 0.50% | 700 |
| 1.00% | -- |

The typical product properties are stated for guidance only and may change overtime . Please refer to the product specific Kemira Sales Specification for the actual product specification.

## REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL PRISHTINA SH.A.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **" Profitech " SH.P.K.**

**Blerina Huruglica**